



01/Nr. 984 /2020

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 24, neni 40, Ligji për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049 neni 7, Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës Nr. 06/L-133 për vitin 2019 neni 6, paragrafi 2, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2020 merr:

VENDIM
PËR RRRITJEN E TË HYRAVE VETANAKE KOMUNALE PËR VITIN 2019

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për rritjen e të hyrave vetanake komunale për vitin 2019.
2. Të hyrat vetanake të planifikuara gjatë vitit 2019 kanë qenë në shumë prej 289,129.00, kurse gjatë vitit 2019 komuna ka realizuar mjete në shumë 321,435.51 €, që d.m.th. se kemi pasur një tejkalim të të hyrave vetanake në lartësi prej 32,306.51 €. Pra në total, financimi i buxhetit nga të hyrat vetanake për vitin 2019 do të jetë 321,435.51 €.
3. Këto mjete në shumë prej 32,306.51 €, si rezultat i tejkalimit të planifikimit i shpërndajmë në kategoritë ekonomike të shpenzimeve, si vijon: mallra dhe shërbime në shumë prej 12,306.51 € si dhe subvencione dhe transfere në shumë prej 20,000.00 €.
4. Në kategorinë ekonomike Mallra dhe shërbime në shumë prej 12,306.51 € në programet dhe nën-programet, si vijon:
 - Zyra e kryetarit (160) nën-programi zyra e kryetarit (16035), kodi funksional (0111), shuma prej 5,000.00 €,
 - Shëndetësia dhe mirëqenia sociale (730) nën-programi shërbimet e shëndetësisë primare (75050), kodi funksional (0721), shuma prej 5,000.00 €.
 - Arsim dhe shkencë (920) nën-programi administrata (92175), kodi funksional (0980), shuma prej 2,306.51 €.
5. Në kategorinë ekonomike Subvencione dhe transfere në shumë prej 20,000.00 € në programin dhe nën-programin, si vijon:
 - Zyra e kryetarit (160) nën-programi zyra e kryetarit (16035), kodi funksional (0111), shuma prej 20,000.00 €.
6. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive,
- Ministria e Financave dhe Transfereve - Departamenti i Buxhetit,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 27.02.2020

Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava





Republika e Kosovës - Republic of Kosova
Komunës - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 983 /2020

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11,12,40, Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës Nr. 06/L-133 për vitin 2019 neni 9, nën-paragrafi 1.2 dhe paragrafi 5, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë neni 27, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2020 merr:

VENDIM

PËR BARTJEN E MJETEVE TË PA SHPENZUARA NGA TË HYRAT VETANAKE KOMUNALE TË VITIT 2018 DHE 2019 NË VITIN VIJUES 2020

1. Kuvendi i komunës miratoi për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake komunale të vitit 2018 dhe 2019 në vitin vijues 2020.
2. Të hyrat e bartura nga viti 2018 në vitin 2019 kanë qenë në shumën prej 193,188.88 €, prej tyre janë shpenzuar në shumën prej 169,163.28 €, kurse për bartje kanë mbetur edhe 24,025.60 €. Të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2019 kanë qenë në shumë prej 321,435.51 €, prej tyre janë të shpenzuara 259,569.20 €, kurse për bartje kanë mbetur edhe 61,866.31 €. Pra në total, të hyrat vetanake të vitit 2018 dhe 2019 janë në shumë prej 85,891.91 €, të cilat i bartim për vitin 2020.
3. Këto mjete sipas pikës 2 (në shumë prej 85,891.91 €), i shpërndajmë nëpër këto kategori ekonomike të shpenzimeve, si vijon:
 - mallra dhe shërbime në shumë prej 12,424.67 €;
 - subvencione dhe transfere në shumë prej 20,136.87 € dhe
 - shpenzime kapitale në shumë prej 53,330.37 €.
4. Në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime në shumë prej 12,424.67 €, në programet dhe nën-programet si vijon:
 - Zyra e kryetarit (160) nën-programi (16035), kodi funksional (0111), shuma prej 5,000.00 €;
 - Shëndetësia dhe mirëqenia sociale (730) nën-programi (75050), kodi funksional (0721) shuma prej 5,000.00 €;
 - Arsim dhe shkencë (920) nën-programi administrata (92175), kodi funksional (0980), shuma prej 2,424.67 €
5. Në kategorinë ekonomike Subvencione dhe transfere në shumë prej 20,136.87 €, në programin dhe nën-programin, si vijon:
 - Zyra e kryetarit (160) nën-programi (16035), kodi funksional (0111) shuma prej 20,136.87 €.

6. Në kategorinë ekonomike Shpenzime Kapitale në shumë prej 53,330.37 € në programet dhe nën-programet dhe në projektet, si vijon:
Planifikimi urban dhe mjedisi (660) nën-programi (66480), kodi funksional (0620) shuma prej 25,455.93 €, në projektet si vijon:
“Mjete të lira për bashkëinvestime” kodi i projektit (45641) shuma prej 10,000.00 €;
“Shtrimi me kubëza betoni i rrugicave nëpër zonat rurale të Hanit të Elezit (Gorancë, Krivenik, Paldenicë, Pustenic, Seçishtë, Meliq, Dimcë, Lagja e re, Uji i Thartë)” kodi i projektit (45702) shuma prej 15,455.93. €.
- Shëndetësia dhe mirëqenia sociale (730) nën-programi (75050), kodi funksional (0721) shuma prej 296.00 €, në projektin si vijon:
“Autoambulancë për QKMF-në” kodi i projektit (48939) shuma prej 296.00 €;
- Arsim dhe shkencë (920) nën-programi administrata (92175), kodi funksional (0980), shuma prej 27,578.44 €, në projektin si vijon:
“Ndërtimi i sallave sportive në Paldenicë dhe Gorancë” (41675) shuma prej 27,578.44 €;
7. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive,
- Ministria e Financave dhe Transfereve - Departamenti i Buxhetit,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 27.02.2020

Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava





01/Nr. 982/2020

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike 03/L-048 neni 45.4, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 64, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2020 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË SHPENZIMEVE TË MJETEVE BUXHETORE PËR VITIN 2019

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin e shpenzimeve të mjeteve buxhetore për vitin 2019.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i shpenzimeve buxhetore për vitin 2019 i hartuar nga drejtoria për buxhet dhe financa.
3. Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë për vitin 2019 është në lartësi prej 2,915,921.00 €, ndërsa ai përfundimtar është 3,205,548.08 €. Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar-dhjetor 2019 është në shumë prej 3,133,209.26 € apo 97.74 %. Prej tyre për paga dhe mëditje janë shpenzuar paga dhe mëditje janë shpenzuar 1,478,773.44 € apo 99.04 %, mallra dhe shërbime 261,825.95 € apo 99.88 %, shpenzime komunale 54,368.73 € apo 99.94 %, subvencione dhe transfere 66,103.40 € apo 99.79 % dhe shpenzime kapitale 1,272,137.74 € apo 95.68 %.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 27.02.2020

Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava





01/Nr. 843/2020

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11,17 shkronja (f), 40, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2020 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN DHE REALIZIM TË PROJEKTIT KAPITAL KANALI I MBYLLUR PËR UJRAT
ATMOSFERIKE NË FSHATIN SEÇISHTË

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për miratimin e projektit kapital “Kanali i mbyllur për ujërat atmosferike” në fshatin Seçishtë në gjatësi prej 230 m dhe dimensione të brendshme 2.00x2.50 m.
2. Ky projekt është vazhdimësi e realizimit të projektit kapital “rregullimi i prrockës dhe kanalizimit fekale në fshatin Seçishtë një pjesë e së cilës është deri te vendi i quajtur Izvor që ka përfunduar në vitin 2019. Ky projekt është i një rëndësie të veçantë për mbrojtjen e pjesëve të caktuara të vendbanimit nga vërshimet e mundshme dhe ujërat e zeza.
3. Projekti në tërësi do të financohet nga Bashkimi Evropian respektivisht IPA II Program për bashkëpunim Ndërkufitarë Kosovë – Republika Veriore e Maqedonisë që komuna jonë së bashku me komunën e Gazibabës –Shkup janë përfituese të IPA fondeve për realizimin e projektit në fjalë.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorja për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- Drejtorja për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 27.02.2020

Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava





Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 1025/2020

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, neni 40.2 shkronja (d), Rregulloren e Punës së Kuvendit neni 15 shkronja (c), Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2020 merr:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2019

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin e punës së kuvendit të komunës për vitin 2019.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2019.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 27.02.2020

Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava

